



MEDIA PËR DIVERSITETIN DHE
INTEGRIMIN E MIGRANTËVE

**TREGUESIT E DIVERSITETIT MEDIVA
Për Vlerësimin e Kapacitetit të Mediave
në Reflektimin e Diversitetit dhe
Promovimin e Integrimit të Migrantëve
*Një Instrument Hulumtues***

Anna Triandafyllidou
në bashkëpunim me
Sam Bennett, Malgorzata Fabiszak, Franziska
Fehr, Eda Gemi, Michal Krzyzanowski, Artur
Lipinski, Sonia McKay, Eugenia Markova, Neil
O'Boyle, Paschal Preston, Iryna Ulasiuk, Jessika
ter Wal



*The MEDIVA Project is co-funded by
the European Fund for Integration of
Third Country Nationals, Community
Actions 2009*

EUROPEAN UNIVERSITY INSTITUTE, FLORENCE
ROBERT SCHUMAN CENTRE FOR ADVANCED STUDIES

TREGUESIT E DIVERSITETIT MEDIVA
për vlerësimin e kapacitetit të mediave në
reflektimin e diversitetit dhe promovimin e
integritit të migrantëve
Një Instrument Hulumtues

ANNA TRIANDAFYLLIDOU
NË BASHKËPUNIM ME
SAM BENNETT, MALGORZATA FABISZAK, FRANZISKA
FEHR, EDA GEMI, MICHAL KRZYZANOWSKI, ARTUR
LIPINSKI, SONIA MCKAY, EUGENIA MARKOVA, NEIL
O'BOYLE, PASCHAL PRESTON, IRYNA ULASIUK,
JESSIKA TER WAL

PROJEKTI MEDIVA

Ky tekst mund të shkarikohet nga interneti vetëm për qëllime kërkimore personale. Riprodhime të mëtejshme për arsye të tjera, qoftë në kopje të shtypura ose në mënyrë elektronike, bën të nevojshme kërkimin e miratimit të autorëve, të redaktorëve. Nëse citohet ose përmendet, duhet bërë një referencë e plotë mbi emrin e autorëve, të redaktorëve, të titullit, të materialit, të vitit dhe botuesit.

© 2012 MEDIVA Project

Printed in Italy
European University Institute
Badia Fiesolana
I – 50014 San Domenico di Fiesole (FI)
Italy
www.eui.eu/RSCAS/Publications/
www.eui.eu
cadmus.eui.eu

Projekti Hulumtues MEDIVA

Media për Diversitetin dhe Integrimin e migrantëve: Konsolidim i Njohurive dhe Vlerësimi i Praktikave Mediatike në Europë

Projekti MEDIVA kërkon të përforcojë kapacitetin e mediave në pasqyrimin e diversitetit gjithmonë e në rritje të shoqërive Europiane dhe promovimin e integritit të migrantëve. Për arritjen e këtij objekti, projekti ka organizuar literaturën e përfutur deri më sot, dhe ka krijuar një bankë të dhënash të kërkueshme në internet, me të gjitha studimet e kryera mbi mediat dhe diversitetin/integrimin, e cila është në dispozicion të lirë për t'u përdorur nga specialistët mediatik si edhe nga publiku i gjërë. Duke u bazuar mbi një punë tashmë ekzistuese dhe duke e kombinuar atë me një seri intervistash me gazetarë të specializuar në Europë, projektit MEDIVA ka mundur zhvillimin e një grupi treguesish për monitorimin e mediave (që janë të disponueshme në 8 gjuhë) të cilat mund të jenë të aplikueshme në zhanre të ndryshme mediatike, në shtete të ndryshme dhe që mund të sigurojnë bazat e vetë-vlerësimit, të vlerësimit nga të tjerët si dhe nga mekanizmat mediatikë monitorues në të ardhmen. Katër raporte tematike janë shkruajtur për të pasqyruar sesi gazetarët dhe specialistët mediatikë trajtojnë çështjen e diversitetit/integritit të migrantëve në katër sektorë mediatikë: rekrutimin dhe kushtet e punësimit; trajnimin e ofruar; aplikimin e kodeve të etikës gazetareske; përgatitjen dhe prodhimin e lajmeve; prezantimin e diversitetit në media (përmajtja e lajmeve). Së fundi, pesë konferenca rajonale kanë mundur shkëmbimin e mendimeve dhe eksperiencave midis specialistëve mediatikë, OJQ-ve dhe studiuesve mbi rolin e mediave në promovimin e integritit të migrantëve.

Projekti MEDIVA realizohet nga Qendra e Studimeve të Avancuara Robert Schuman dhe koordinohet nga Profesora Anna Triandafyllidou (anna.triandafyllidou@eui.eu) Instituti i Universitetit European të Firences (EUI) dhe Qendra e Studimeve të Avancuara Robert Schuman (RSCAS) nuk janë përgjegjës për opinionin e shprehur nga autorët.

Anna Triandafyllidou është kordinuesja e Projektit MEDIVA. Ajo është profesore (me kohe të pjesëshme) pranë Qendrës së Studimeve të Avancuara Robert Schuman, Instituti i Universitetit European të Firences, Itali. **Iryna Ulasiuk** dhe **Eda Gemi** janë asistente shkencore të Projektit MEDIVA pranë Institutit të Universitetit European të Firences, Qendra e Studimeve të Avancuara Robert Schuman.

Jessika ter Wal është studiuese pranë qendrës MiraMedia, Hollandë, që nga viti 2004. Ajo është gjithashtu Studiuese e Parë (Senior Research Fellow) pranë Qendrës Studimore Europiane të Migracionit dhe Marrëdhënieve Etnike (ERCOMER), Universiteti i Utrehtit, 1997-2004, dhe Asistent Professore në Fakultetin e Qeverisjes (School of Governance), Universiteti i Utrehtit, 2008-2010.

Paschal Preston është profesor në Fakultetin e Komunikimit të Universitetit të Qytetit të Dublinit - DCU. Ai është Drejtori themelues i njësisë hulumtuese COMTEC pranë DCU si dhe anëtarë i qendrës kërkimore SIM. **Neil O'Boyle** është lektor pranë Fakultetit të Komunikimit të DCU, ku kryen gjithashtu funksionin e drejtorit të ekipit hulumtues mbi Mediat Ndërkombëtare, Ndërkulturalismin dhe Migracionin. **Jim Rogers** është studiues post doktorat dhe **Franziska Fehr** është studiuese në Fakultetin e Komunikimit të DCU.

Sam Benet është student Doktorant (Phd) në Fakultetin e Anglishtes, Universiteti Adam Mickiewicz.

Artur Lipiński është Asistent Profesor në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Gazetarisë, Universiteti Adam Mickiewicz. **Malgorzata Fabiszak** është Professore e Asociuar në Fakultetin e Anglishtes, Universiteti Adam Mickiewicz dhe shefe e Departamentit të Linguistikës Konjitive. **Michał Krzyżanowski** është Asistent Profesor në Fakultetin e Anglishtes, Universiteti Adam Mickiewicz, Poznań, si dhe Profesor Vizitor në Fakultetin e Studimeve të Mediave dhe Komunikimit, Universiteti i Örebro dhe Studiuese e Parë (Senior Research Fellow) në Linguistikën dhe Gjuhën Angleze, Universiteti i Lancaster, Mbretëria e Bashkuar.

Eugenia Markova është studiuese në Projektin MEDIVA. Ajo është Studiuese e Parë e Migracionit (Senior Migration Research Fellow) (me kohë të pjesëshme) në Institutin e Studimeve të Kushteve të Punës (Working Lives Research Institute) dhe Lektore e Parë (Senior lecturer) në Shkollën e Bisnesit të Universitetit Metropolitan të Londrës. **Sonia McKay** është përgjegjëse shkencore e projektit MEDIVA. Ajo është Professore e Studimeve Sociale dhe Ligjore Europiane në Institutin e Studimeve të Kushteve të Punës në Universitetin Metropolitan të Londrës.

Për më shumë informacion:

MEDIVA Project

Robert Schuman Centre for Advanced Studies

European University Institute

Via delle Fontanelle, 19

50016 San Domenico di Fiesole (FI), Italy

Fax: + 39 055 4685 770

E-mail: anna.triandafyllidou@eui.eu or iryna.ulasiuk@eui.eu

<http://www.eui.eu/RSCAS/>

Hyrje

Europa ka provuar tensione të mëdha midis shumicave nacionale dhe minoriteteve fetare ose etnike, sidomos përsa i përket migrantëve dhe pasardhësve të tyre, gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit. Konfliktet e tilla të dhunshme kanë ndodhur në Anglinë veriore midis Britanikëve dhe të rinjve myslimanë Asiatë (2001); trazirat civile midis komuniteteve myslimane Franceze Magrebiane (2005); kriza e karikaturave Daneze në 2006 që shpërtheu pas publikimit të skicave të profetit Muhamed. Komunitetet muslimane i janë nënshtruar një survejimi intensiv menjëherë pas ngjarjeve terroriste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (2001), Spanjë (2004) dhe Britani (2005) dhe ka një rritje të vazhdueshme të skepticizmit midis shteteve Europiane në lidhje me anëtarësimin e mundshëm të Turqisë në BE, një shtet i cili si nga aspekti socio-kulturor ashtu dhe ai fetar është i ndryshëm nga 27 shtetet anëtare të BE-së. Tensione janë shfaqur gjithashtu dhe në rastin e polemikave mbi ndërtimin e xhamive lokale në Itali, Greqi, Gjermani ose Francë.

Së fundi, ne kemi qenë dëshmitarë të ngjarjeve tragjike të krimeve të motivuara nga urrejtja raciale nga përkrahësit e të djathtës ekstreme në Norvegji në verën e 2011 dhe në Firence në Dhjetor 2011. Mëtej, skandali më i fundit i vrasjeve të motivuara nga urrejtja raciale në Gjermani në periudhën 2000-2007 nga ekstremistët e djathtë si dhe paaftësia e policë në identifikimin e fajtorëve deri në 2011, janë ngjarje jashtëzakonisht shqetësuese.

Diversiteti etnik dhe fetar si dhe tensionet që ato sjellin mund të përshkallëzohen akoma më shumë nga kriza ekonomike që ka goditur pjesën më të madhe të BE-së (edhe pse në shkallë të ndryshme) duke filluar që nga viti 2008. Në kushtet e rritjes së papunësisë si dhe të pasigurisë, shtetasit që nuk janë qytetarë të BE-së por që janë banorë të BE-së priren të bëhen objekt i ksenofobisë dhe i sjelljeve raciste. Partitë e ekstremit të djathtë si Fronti Nacional në Francë, LAOS në Greqi ose Lega e Veriut në Itali i japin përgjigje të thjeshta dhe të përshtatshme shqetësimeve të qytetarëve duke i hedhur migrantëve fajin për të gjitha problemet që përballojnë shoqëritë Europiane.

Në këtë kontekst, tema e integritit të shtetasve të vendeve të treta (TCN) bëhet gjithnjë dhe më akute në emër të ruajtjes të kohezionit social si dhe për të ndihmuar shoqëritë Europiane të tejkalojnë krizën. Në këto kushte, Media ka një rol për të luajtur si në promovimin e debatit politik ashtu edhe në përfaqësimin në media të atyre opinioneve që janë pro integritit dhe jo fobik ndaj migrantëve.

Iniciativa të shumta janë ndërmarrë nga institucione Europiane si për shembull nga Agjencia e të Drejtave Themelore (FRA), Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit dhe Çështjeve Sociale (DG EMPL), Unioni i Transmetimeve Europiane (EBU), Federata Internacionale e Gazetareve (IJF), të cilat kanë arritur të përforcojnë kapacitetin e mediave në pasqyrimin e diversitetit. Studime të ndryshme kanë arritur të identifikojnë praktikën më frytdhënëse dhe të prezantojnë ato nga këndvështrimi i rritjes së ndërgjegjësimit midis kompanive dhe profesionistëve mediatikë. Ndërmjet këtyre iniciativave ia vlen të përmendet projekti *Media4Diversity* i përfunduar në 2009 dhe *Diversity Toolkit* për Programe Faktuale të Shërbimeve Publike Televizive, publikuar në 2007 me mbështetjen e EBU dhe të FRA; Projekti *Tuning into Diversity* si edhe MMIM, *Dialogue* dhe projektet MEM, konferenca e 2010 dhe zhvillimi i *Diversity Toolkit* për OJQ-të; Iniciativa e Etikës Gazetareske të IFJ dhe Raportet Vjetore mbi Mediat dhe Dialogun Ndërkulturorë të publikuara nga organizata MIRAMEDIA e cila është gjithashtu partnere e këtij projekti.

Qëllimi i projektit MEDIVA është të investojë mbi këtë punë dhe ta çoj atë disa hapa më përpara duke përmirësuar infrastrukturën e njohjeve të disponuara në këtë fushë (përmes një banke të dhënash dhe një sërë raportesh tematike). Në vazhdim projekti ka krijuar një set të Vlerësimit të Treguesve të Mediave të cilat kanë si qëllim vlerësimin e kapacitetit të çdo institucioni mediatik (në shtyp, TV ose internet) në pasqyrimin e diversitetit në lidhje me migracionin dhe promovimin e integrimin e migrantëve.

Banka e të dhënave MEDIVA

Arritja e parë e projektit MEDIVA ka qenë te organizojë njohjen/literaturën e prodhuar në një bankë të dhënash të disponueshme në një platformë elektronike:

<http://www.eui.eu/Projects/MEDIVA/Bibliography.aspx/>

Kjo bankë te dhënash përmban më shumë se **250 studime** dhe dokumente të publikuara **në tetë gjuhë Europiane** (Bullgarisht, Hollandisht, Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Greqisht, Italisht, Polonisht) të cilat vlerësojnë kapacitetin e mediave Europiane (duke përfshirë shtypin e shkruar, TV, radio, internet) në pasqyrimin e diversitetit dhe promovimin e integritit të migrantëve.

Banka e të dhënave është e organizuar sipas **katër fushave tematike: përmbajtja e lajmeve rreth migrantëve, bërja e lajmeve dhe praktikat e prodhimit të programeve, rekrutimi dhe punësimi, dhe procedurat e trajnimit**. Është lirisht e disponueshme në internet, thjeshtësisht e përdorshme, me të gjitha lehtësimet për kërkimin e autorit, titullit dhe fjalës kyç.

Raportet tematike të MEDIVA

Përtej bankës së të dhënave, projekti MEDIVA ka krijuar një set me Katër Raportë Tematike. Këto raportë janë bazuar në analizat e literaturës akademike, politike dhe dokumentave relativë të përmbledhura në bankën e të dhënave si dhe në intervistat kualitative gjysëm të strukturara, të kryera me një grup prej 68 gazetarësh të njohur dhe profesionist mediatikë në gjashtë shtetë (Greqi, Irlandë, Itali, Hollandë, Poloni, dhe Britani e Madhe) përgjatë periudhës së verës dhe vjeshtës të 2011. Raportet e plota janë të disponueshme në:

<http://www.eui.eu/Projects/MEDIVA/Reports.aspx>

Më poshtë do t'ju prezantojme disa nga rezultatet/gjetjet kryesore pasi ato kanë lidhje me krijimin e Treguesve të Vlerësimit të Mediave.

MEDIVA Raporti Tematik 2011/01- Migrantët dhe Praktikrat Mediatike të Prodhimit të Lajmeve

Analizat studimore kanë treguar se pavarësisht tendencave pozitive të vëzhguara, praktikrat e prodhimit të lajmeve mbi temën e migracionit vazhdojnë të jenë ngushtësisht të lidhura me disa sfida.

- Lajmet mbi migracion mbledhen kur dicka sensacionale ose e vlefshme për tu raportuar ndodh. Dhe zakonisht këto lajme i referohen ngjarjeve ‘negative’ mbi migrantët ose migracionin.
- Axhenda e përgjithshme politike influencon konsiderueshëm mënyrën e prezantimit të lajmeve mbi migracionin.
- Por shumë gazetarë me interes të vërtet për cilësinë dhe paanshmësinë e raporteve të tyre shkojnë përtej axhendës politike duke mbuluar tema të cilat ata i konsiderojnë se kanë vlera raportimi pikërisht sepse publiku dëshiron të informohet mbi to.
- Temat e reportazheve mbulojnë zakonisht histori të individualizuara dhe të ngarkuara emocionalisht që mund të kenë interesë për publikun e gjërë, histori të cilat nxjerrin në pah aspektet «njerëzore» dhe të «përditshme» të migracionit (përfshire ribashkimin e familjeve, histori pozitive mbi integrimin social, njerëz që migrojnë si pasojë e konflikteve, ose sesi migrantë përdorin dhe keqpërdorin sistemin e ndihmës sociale)
- Gazetaret shpesh konsultohen me migrantët, komunitetet e tyre, OJQ-të si dhe faktorë të tjerë jo shtetërorë, të cilët ata i konsiderojnë më të besueshëm për temat e migracionit. Formula e ndjekur është: duhet ti drejtohesh njerëzve të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejta me temën.
- Gjithësesi, qasja e burimeve të tilla «alternative», përveç, për shembull, agjencive shtetërore të lajmeve, autoriteteve qeveritare ose ekspertëve akademik, nuk është gjithmonë rruga më e lehtë pasi shumë migrantë nuk i besojnë gazetarët dhe si pasojë kanë frikë të flasin ose sepse gazetarët mund mos të kenë qasje në rrjetet përkatëse me qëllim që të përftohet besimi reciprok. Faktikisht, ekspertët mund të kthehen në urë komunikimi duke i dhënë mundësi zërit të migrantëve të dëgjohej.
- Shqetësimi se zëri i migranteve nuk degjohet aq sa duhet, akoma dhe për tema që janë drejtpërdrejt të lidhura me to, është akoma aktual.
- Për më tepër, institucionet mediatike nuk e mbulojnë temën e migracionit në vazhdimësi. Media ka tendencë të «furnizojë» hapësirën mediatike me informacion të vazhdueshëm vetëm kur ndodh dicka dramatike, por shumë shpejt në periudha «normaliteti» tema harrohet, duke nxitur kështu publikun të mendojë se migracioni është një fenomen që lidhet vetëm me “problemet/konfliktet/veshtirësitë”.

Edhe pse studimi ynë paraqet një figurë ambivalente me tendenca kontrastive (duke reduktuar buxhetin editorial dhe numrin e gazetarëve profesionist me orar të plotë por edhe rritjen e pjesmarrjes së qytetareve dhe shumëfishimin potencial të burimeve lajmëdhënëse nëpërmjet telefonave të teknologjisë së fundit dhe mediave sociale), përgjatë 5 vjetëve të fundit janë ndërmarrë gjithashtu iniciativa të rëndësishme që promovojnë ndërgjegjësimin mbi diversitetin në media. Ndërmjet tyre ne diferencuam projektin *Media4Diversity*, parimet Camden për lirinë e shprehjes dhe barazisë, Iniciativën e Etikës gazetareske, Kartën e Romës në lidhje me raportimin mbi migrantët dhe refugjatët si dhe *Diversity Toolkit* për institucionet publike televizive.

Për më shumë shihni:

<http://www.eui.eu/Projects/MEDIVA/Documents/Reports/reports/MEDIVAThematicReport201101.pdf>

MEDIVA Raporti Tematik 2011/02 –Përmbajtja e Mediave/Lajmeve mbi Migrantët

Përmbajtja e Mediave/Lajmeve

Një nga gjetjet e mëparshme kërkimore tashmë e konfirmuar është se kur bëhet fjalë për temat e migracionit mediat shpesh kultivojnë qëndrime opozitare midis pozitives 'ne' dhe negatives 'ata'. Migrantët janë shpeshherë të prezantuar si grup dhe jo si individë, dhe me pas i atribuohen karakteristika kërcënuese, ose të shoqëruara me probleme, sidomos në lidhje me krimet dhe konfliktet. Por disa studime kanë identifikuar gjithashtu përdorimin e argumenteve humanitare gjatë diskutimeve mediatike. Ajo çka është verifikuar gjithsesi në literaturën përkatëse është se migrantët shfaqen në mënyre më negative sesa jo migrantët brënda të njëjtit kontekst lajmesh. Disa studime të tjera kanë treguar efektet negative të mënyrës sesi mediat kryesore mbulojnë temën e migracionit në qëndrimin dhe trajtimin e migrantëve nga ambjenti social.

Shembuj pozitiv të mbulimit të temave migratore janë gjetur në shtypin lokal, sidomos në zonat e metropoleve, në gazeta cilësore që kanë reporter të specializuar mbi temën dhe që u është lejuar raportimi dhe investigimi në thellësi, kontekstualizimi i reportazheve, dhe programimi nga Shërbimi Publik i Transmetimeve në një numër vendesh. Siç është konfirmuar gjithashtu edhe nga intervistat, gjetja e shembujve më pozitivë varet nga lloji i mediave, politika editoriale dhe axhenda e lajmeve.

Në përgjithësi, migrantët e brezit të dytë dhe të tretë janë me të dukshëm, të cituar më shpesh, dhe portretizimi i tyre është më i ekuilibruar në krahasim me atë të migranteve të rinj apo të refugjatëve. Megjithatë, disa studime pretendojnë se citimet mbi minoritetet ose burimet e migrantëve janë në përgjithësi ende mjaft të kufizuara, por gjithsesi pak më mirë duket se shfaqen në shtypin cilësor dhe lokal. Të intervistuarit nga MEDIVA zbuluan gjithashtu se promovimi i migrantëve në televizor arrihet më lehtë por më shumë në zonën e programeve argëtuese se sa në lajmet kryesore dhe debatet politike.

Një gjetje ilustruese në lidhje me mbulimin nga mediat të temave migratore është përqafësimi stereotipik i myslimanëve në media në vitin 2000, e cila identifikon imazhin e mashkullit mysliman me fundamentalizmin fetar dhe trajton femrat myslimane si viktime të një kulture të prapambetur me perceptime fetare inferiore. Edhe pse në raste të veçanta ka pasur mundësi për portretizime më të ekuilibruara, investime dhe raportime më të thella, si dhe debate rreth pozicionit social të Myslimanëve, sipas shumicës së studimeve mediatike ajo çka mbizoteron është figura e Islamit si një kërcënim për sigurinë, kulturën dhe vlerat themelore të Perëndimit. Kjo gjë ka çuar gjithashtu në një ndryshim të përgjithshëm kur temat e migracionit janë venë në diskutim, duke e zhvendosur vëmendjen nga pjesmarrja tek konfliktet sociale, duke arritur në disa raste dhe tek përzjerja e reportazheve të mediave të huaja mbi konfliktet ndërkombëtare me axhendën kombëtare të lajmeve.

Në shumë studime të kryera në vendet e mbuluara nga ky projekt, del se në reportazhet e krimeve origjina etnike apo kombëtare e të dyshuarve vazhdon akoma të përmendet, ose - siç del nga intervistat e kryera – ndërgjegjësimi për t'ju shmangur një praktike të tillë sa vjen e dobësohet. Gazetarët e intervistuar theksojnë zbatimin e standarteve profesionale, dhe të vetëdijes specifike në lidhje me domosdoshmërinë e një raportimi të paanshëm dhe të saktë të lajmeve mbi temën e migrantëve siç ndodh me pjesën tjetër të lajmeve, sidomos në shtypin cilësor dhe mediat publike. Megjithatë, një pjesë e intervistave konfirmojnë mungesën e saktësisë së termave të përdorura ose të specifikimit të statusit dhe origjinës së migrantëve në veçanti nga gazetarët apo kryeredaktorët e gazetave më të njohura të cilat karakterizohen nga një mungesë interesi për këtë temë.

Me kalimin e kohës, përdorimi i burimeve të migrantëve në raportet e shtypit shfaqet i zvogëluar dhe arsyeja për këtë mund të jetë dhe ulja e numrit të gazetarëve të specializuar si dhe lodhja apo mosdëshira e gazetarëve me prejardhje migrante të identifikohen ose të konsiderohen si specialistë të komunitetit të migrantëve.

MEDIVA Raporti Tematik 2011/02 - Përmbajtja e Mediave mbi Migrantët (vazhdim)

Në bazë të rishqyrtimit të literaturës përkatëse, nuk bëhet e mundur identifikimi i një tendence të përbashkët në zhvillimin e përmbajtjes së mediave: disa studime hedhin dritë mbi portretizimet negative dhe kuadrin përkatës, ndërsa publikime të tjera e konsiderojnë rritjen e raporteve investigative, kundër-argumentave, dhe përdorimin e burimeve migratore si shënja të një portretizimi më pak esencial.

Disa projekte synojnë në përmirësimin e portretit të migrianteve, p.sh. duke vendosur rrjete dialogu me qëllim që të krijohen ura lidhëse midis organizatave të migrantëve dhe profesionistëve mediatikë. Intervistat e kryera kanë dhënë gjithashtu shembuj pozitivë të institucioneve mediatike të cilat kanë investuar si në trajnimin profesional të personelit të tyre ashtu edhe në lehtësimin e raporteve të sakta mbi diversitetin etnik, fetare dhe kulturorë. Institucione të tjera mediatike mbështëten në politika editoriale statike për të garantuar kësisoj cilësinë gazetareske në përgjithësi, ose i japin vëmendje të veçantë kërkimit dhe përgatitjes së migrantëve të ftuar dhe burimeve respektive.

Megjithatë, sipas vlerësimit tonë, pozicioni social i shtetasve të vendeve të treta, nuk adresohet në menyrë specifike në praktikën e përmbajtjes së mediave. Kjo është një temë që meriton hulumtim të mëtejshme, siç mund të ndodhë dhe me skemat e ndërgjegjësimit - të frymëzuara nga logjika e diversitetit racial apo etnik – të cilat janë më pak efektive kur bëhet fjalë për diversitetin e krijuar nga migracioni i ri dhe pozicioni social i shtetasve të vendeve të treta.

Për më tepër, ky raport rekomandon që studimi të marrë parasysh ndryshimet që ka pësuar profesioni i gazetarisë si dhe rolin e gazetarëve në debatin publik rreth temave të integritit të migrantëve. Analiza e përmbajtjes së mediave do të duhet të përfshijë jo vetëm perfaqësimin e grupeve sociale dhe vlerësimet e tyre negative apo pozitive në lajme, por gjithashtu, siç është bërë në pjesën e studimeve të vlerësuara, të shqyrtojë sesi migrantët dhe tema e integritit janë shpjeguar, vlerësuar dhe treguar në lajme, si dhe çfarë pretendime dhe kërkesa janë bërë përsa i përket korigjimit dhe pasojave, brenda kontekstit të ndryshimeve të ndodhura në debatin publik rreth temës së integritit të migrantëve.

Për më shumë shihni:

<http://www.eui.eu/Projects/MEDIVA/Documents/Reports/reports/MEDIVAThematicReport201102.pdf>

MEDIVA Raporti Tematik 2011/03 - Rekrutimi në Media dhe Praktikën e Punësimit

“Si të prezantohesh?” Praktikën e rekrutimit në Industrinë e Mediave

□ Një raport i rëndësishëm midis vendit ku institucionet mediatike janë të lokalizuara dhe zbatimit të masave formale anti-diskriminuese në rekrutime është identifikuar, edhe pse një e katërta e të anketuarve nuk e dinin nëse masa të tilla aplikoheshin apo jo në mediat e tyre. Nga ana tjetër, mëse gjysma e të intervistuarve në Britani të Madhe dhe gjysma e atyre në Hollandë konfirmuan zbatimin e masave anti-diskriminuese në praktikën e tyre të rekrutimit. Asnjë nga të anketuarit në Itali dhe Irlandë nuk ishte në dijeni të masave të tilla të adoptuara nga kompanitë e tyre mediatike. Megjithatë, kjo nuk duhet të interpretohet si tregues se institucionet mediatike të anketuara në këto vende nuk janë të hapura ndaj një game të larmishme të aplikimeve për punësim.

□ Asnjë nga të intervistuarit tanë në Irlandë, Itali dhe Greqi nuk ishte në dijeni të ndonjë praktike të monitorimit të diversitetit të aplikuar nga kompanitë e tyre. Në Mbretërinë e Madhe, të anketuarit iu referuan një procesi aplikimi që i kërkon të gjithë aplikantëve të plotësojnë dhe të dorëzojnë një formular mbi barazinë dhe diversitetin. Rregullat e vendit mundet ndonjëherë të pengojnë monitorimin e diversitetit. Në rastin e Hollandës, siç është shpjeguar, pyetja e përkatësisë etnike e një aplikanti është e shkruajtur në formën përkatëse të punësimit, por plotësimi ose jo i saj nuk është i detyrueshëm. Monitorimi i diversitetit është penguar më tej dhe nga kontratat e punës. Gazetarët e pavarur mund të regjistrohen vetëm në rast se kanë punuar për një kompani mediatike për më shumë se një muaj. Gazetarët migrantë rrallë qëllon të regjistrohen kryesisht për shkak të natyrës së kontratave të tyre.

□ Një numër shumë i vogël i të anketuarve konfirmoi se kompanitë e tyre mediatike kishin reklamuar vendet e lira të punës. Disa të intervistuar të tjerë përmenden publikimin e vendeve të lira të punës si dhe procesin e saktë të përzgjedhjes si fitimprurëse jo vetëm për promovimin e “imazhit të punëdhënësit” si “jo diskriminues”, por për të gjetur personin e duhur për punën përkatëse. Siç komenton një nga të intervistuarit “*preokupimi ynë është të gjejmë personin e duhur për punën e duhur*; dhe jo “*hajde të sigurojmë se do të kemi pakica etnike*”. (int.40)

□ Disa nga të anketuarit argumentuan se migrantët dhe pakicat etnike mund të kenë pjesën e tyre të fajit për faktin e mungesës së diversitetit midis të punësuarve në institucionet mediatike. Ata ishin në mëdyshje nëse duhet apo jo të aplikonin për tu punësuar në media dhe kjo ka kontribuar në mungesën e diversitetit në industrinë mediatike.

Pengesat Specifike për Punësimin e Migrantëve në Media

□ Nepotizmi dhe mungesa e përvojës në vendin ku ato kanë migruar, janë parë si pengesa shtesë specifike për migrantët dhe pakicat etnike. Mediat në Hollandë dhe Irlandë janë parë ende, nga të anketuarit tanë, si një “bastion i bardhë” ku është e vështirë të depërtosh në to. Personeli i ri i punësuar vjen kryesisht nga të njëjtat shkolla duke riqarkulluar kështu fuqinë punëtore ekzistuese.

□ Ka pasur dallime midis vendeve përsa i përket mënyrës se si të intervistuarit interpretuan nivelin e aspiratave të migrantëve për të punuar në media. Në Hollandë, një vend me tradita të gjatë migracioni, karriera në media nuk është e artikuluar si popullore sidomos ndërmjet migrantëve të rinj me origjinë jo perëndimore. Përparësi i është dhënë karrierës dhe studimeve në mjekësi, juridik, ekonomi dhe menaxhim biznesi pasi këto sektorë janë konsideruar se ofrojnë më shumë siguri dhe status. Kjo preferencë karriere mund të ketë rrënjët në eksperiencën e kaluar në vendin e origjinës.

□ Disa nga të intervistuarit e shohin krizën ekonomike të viteve të fundit si një pengesë kryesore për rekrutimin dhe punësimin në media. Shprehja “nuk ka punë”, u përsërit nga të anketuarit në të gjitha vendet e studimit. Kërkesa e ulët për rekrutim dhe oferta e tepërme e njerëzve shumë të kualifikuar, e shoqëruar kjo me “një sasi jashtëzakonisht të madhe konkurrence” përbëjnë pengesa kryesore të përgjithshme për punësim në media.

□ Diferencat kulturore mund të paraqesin pengesa shtesë për aplikantët migrantë në media. Një gazetar hollandez me origjinë Surinameze Hindustani iu referua mbajtjes së shamisë si shkak i cili krijon një pengesë shtesë për zënien e një vendi punë në industrinë e mediave.

MEDIVA Raporti Tematik i 2011/03 – Rekrutimi në Media dhe Praktikën e Punësimit (vazhdim)

Diversitetin i Fuqisë Punëtore në Media: A mund të flasim për diskriminim?

□ Një raport mjaft i rëndësishëm u gjet midis vendit ku media është e lokalizuar dhe zbatimit të politikave të barazisë. Asnjë nga të anketuarit në Greqi, Itali dhe Poloni nuk i dha përgjigje pozitive pyetjes rreth ekzistencës së politikave të barazisë në kompanitë mediatike ku ata punojnë. Në kontrast kjo me të gjithë të intervistuarit në Britaninë e Madhe, gjysmën e atyre në Hollandë dhe pak më shumë se një çerek i atyre në Irlandë, të cilët konfirmuan zbatimin e politikave të barazisë nga kompanitë mediatike ku ata punojnë. Disa nga të intervistuarit në Itali përmendën se parimet e barazisë janë të kufizuara në nivel individual, duke iu referuar dokumenteve të shkruara udhëzuese për gazetarët.

□ Ka pasur dallime të mjaft të mëdha në punësimin e migrantëve kur shifrat ishin vënë në kontekstin e një vendi të caktuar. Të gjithë të anketuarit në Britaninë e Madhe dhe Hollandë konfirmuan punësimin e punëtorëve migrantë në media. Disa të intervistuar në Irlandë ritheksuan mungesën e diversitetit në mediat irlandeze. Vetëm katër të anketuar në Itali folën për rekrutimin e migrantëve në media, por gjithsesi në numër shumë të vogël. Mediat etnike të kampionit tonë kishin prirje të mbështeteshin ekskluzivisht në fuqinë punëtorëve të migrantëve të pajisur me aftësi gjuhësore përkatëse (gazetat shqiptare në Athinë, stacione radioje etnike në Poloni).

□ Gazetarët migrantë kishin më shumë mundësi për të punuar si të pavarur ose me kontrata afatshkurtëra në të gjitha vendet e anketuara. Duhet theksuar se kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht diskriminimi pasi këto përbëjnë tipare të përbashkëta të punësimit në radio dhe televizion. Megjithatë, situata e migrantëve është karakterizuar nga një i anketuar italian si e pasigurtë.

□ Një i intervistuar nga një kompani publike mediatike në Londër foli për një segmentim të tregut të punës media, ku migrantët nuk ka shanse të gjenden në sektorin e lajmeve. (Më e mundshme është të punësohen në sektorin e arkivës). Punët dallohen në raport me kushtet e punësimit.

Tema në vazhdim

□ Vëndet Europiane me traditën e tyre të migracionit si dhe zbatimin e legjisllacionit për barazinë janë kthyer tashmë në përcaktues të rëndësishëm të praktikave në vazhdim të rekrutimit në media. Kompanitë me praktika rekrutimi mjaft të fuqishme kishin më shumë të ngjarë të reklamnin vendet e lira të punës në kërkim të kandidatit “ideal”. Sidoqoftë, efektiviteti i këtij mekanizmi rekrutimi mundet shpesh të jetë në vartësi të konkurrencës së brendshme.

□ Ndërsa raporti i njeh rreziqet e mundshme të kthimit të diversitetit të fuqisë punëtore si një ushtrim në letër, por ndërkaq i jep rëndësi të veçantë monitorimit si një mekanizëm i burimeve njerëzore që mund të sjellë ndryshimin, pasi ai prezantohet si një instrument i rëndësishëm përmirësimi.

□ Raporti ka argumentuar se skemat efektive dhe inovative në terren mund të reduktojnë pengesat për arritjen e diversitetit mediatik, duke ofruar punësim për njerëzit me prejardhje migratore të cilët mund të kenë kontaktë të pakta dhe njohuri të kufizuara të vendit ku ata kanë vendosur të jetojnë.

□ Perspektiva e të ardhmes – ndërsa janë pranuar sfidat strukturore të zhvillimeve aktuale ekonomike dhe pasojës së "ngrirjes së punësimit"- varet nga zbatimi i rregullave formale dhe i monitorimit. Presionet rregullatore të jashtme kanë potencial të sfidojnë rezistencën ndaj ndryshimit të modelit mono-kulturor që ekziston në industrinë e mediave.

Për më shumë shihni:

<http://www.eui.eu/Projects/MEDIVA/Documents/Reports/reports/MEDIVAThematicReport201103.pdf>

MEDIVA Raporti Tematik 2011/04 - Trajnim mbi Diversitetin në Media

Praktikat e Trajnimit

Të dhënat e intervistave sugjerojnë se vetëm një numër i vogël i profesionistëve të mediave në të gjithë Shtetet Anëtare (me përjashtim të Hollandës dhe Mbretërisë së Bashkuar), janë formalisht të trajnuar mbi diversitetin. Për më tepër, mundësitë për trajnim vërtetohet të jenë të kufizuara, inkurajimi është minimal, dhe në përgjithësi vërehet mungesa e udhëzimeve dhe politikave përkatëse. Nuk përbën surprizë fakti se shumë pak mekanizma monitorimi dhe vlerësimi ekzistojnë, gjë që do të thotë se akoma dhe në institucione ku disa forma trajnimi janë ofruar, rrallë këto kthehen në objekt rishikimi periodik apo përmirësimi.

Qëndrimet ndaj trajnimit mbi diversitetin variojnë në mënyrë të konsiderueshme midis Shteteve Anëtare të këtij studimi. Ndërsa nga një anë gazetarët u shprehën gjerësisht në favor të "arsimit" të vazhdueshëm profesional në forma të ndryshme, disa të tjerë ishin armiqësore ndaj idesë së "trajnimit" pasi e konsiderojnë atë si një ndërhyrje të panevojshme në mënyrën se si ushtrojnë profesion e tyre. Ata që deklaruan në favor të trajnimit mbi diversitetin shprehën rezerva në lidhje me impaktin potencial të saj, me disa sugjerime se nisma të tilla nuk kanë gjasa të kenë sukses pa rritjen e diversifikimit të fuqisë punëtore në media (edhe pse shumica ishin gjithashtu kritik ndaj aplikimit të kuotave në punësim).

Rekomandimet tona për të përmirësuar situatën përfshijnë:

- Institucionet e Prodhimit/Bërjes së lajmeve duhet që në secilin Shtet Anëtar të krijojnë një forum kolektiv për shkëmbimin e ideve dhe informacionit në lidhje me trajnimin mbi diversitetit (të cilat mund të përfshijnë seminare vjetore dhe botimin e një manuali me praktikat më pozitive)
- Një kampion specifik diversiteti (ose departamentit) duhet të themelohet në të gjitha kompanitë mediatike (pavarësisht nga madhësia), me qëllim që përgjegjësia të mos i mbetet vetëm organeve gatezareske dhe institucioneve arsimore.
- Monitorimi strukturor dhe mekanizmat e reagimeve duhet të krijohen, duke venë në përdorim "praktikat më të mira" të cilat do të shpërndahen nëpërmjet forumit kolektiv.
- Angazhimet ndaj diversitetit duhet të inkorporohen horizontalisht, me qëllim që principet e diversitetit të shkruhen në dokumentet organizative.

Për më shumë shihni:

<http://www.eui.eu/Projects/MEDIVA/Documents/Reports/reports/MEDIVAThematicReport201104.pdf>

Treguesit MEDIVA

Nën dritën e këtyre gjetjeve ne kemi ndërtuar një set **Treguesish për Vlerësimin e Mediave i cili ka si qëllim monitorimin dhe vlerësimin e kapacitetit të institucioneve mediatike në pasqyrimin e diversitetit dhe promovimin e integritit të migrantëve**¹. Një monitorim dhe vlerësim i tillë mund të marrë formën e vetë-vlerësimit dhe vetë-monitorimit (nga administruesi i një kompanie mediatike), ose mund të marrë formën e një monitorim institucional dhe mekanizmi vlerësimi të cilat mund të përdoren nga shteti, nga Avokatit i Popullit ose nga shoqata profesionale mediatike.

Treguesit tanë janë **cilësorë dhe sasiorë** dhe janë **organizuar përgjatë katër temave dhe aspekteve kryesore të aktivitetit të mediave** të identifikuara tashmë në bankën e të dhënave dhe studiuar në raportet tematike, më konkretisht:

- 1. Përmbajta e Lajmeve/Mediave (çfarë dhe si janë paraqitur migrantët në lajme)**
- 2. Prodhimi/Bërja e Lajmeve dhe Praktikave të Prodhimit të Programeve (p.sh. filtrimi i lajmeve)**
- 3. Rekrutimi në Media/praktikat e punësimit (rregullat për rekrutimin e pakicave etnike/personeli i përbërë nga migrantët, karriera e këtij stafi, etj)**
- 4. Praktikave të trajnimit në Media (raportimi mbi temat e migrantëve, administrimi i diversitetit)**

Karakteristikat e veçanta të Treguesve të Vlerësimit të Mediave - MEDIVA

Ata janë **kryesisht cilësore në natyrë** (në kapjen e aspekteve të ndryshme të temës së integritit si dhe të rutinës apo praktikave mediatike), por janë **të shprehur në formë sasiorë** (si vlerësim i pikëve të marra: i ulët / i mesëm / i lartë në një sektor të veçantë si dhe në nën-sektor të cilat në vazhdim janë vendosur në shkallë numerike nga 0 (e ulët) deri në 5 (e lartë)).

Së dyti, treguesit tanë janë **projektuar për tu përdorur nga kompani mediatike në vende të ndryshme, me kultura editoriale të ndryshme, me struktura pronësie mediatike të ndryshme, ashtu si dhe tradita gazetarie të ndryshme**. Treguesit janë të shkruajtur në gjuhë të thjeshtë me qëllim që të jenë lehtësisht të perkthyeshem në gjuhën të tjera. Ato përfshijnë udhëzime të qarta metodologjike mbi (a) vlerësimin e përmbajtjes së lajmeve, që duhet të bëhet nga vetë studiuesi/, (b) metodën e intervistës ballë-për-ballë ose telefonike e cila përdoret për të hartuar përgjigjet dhe pikët për treguesit 2, 3 dhe 4 (përgatitja/bërja e lajmeve, punësimi/rekrutimi, trajnimi).

Treguesit tanë janë të përshtatshme për zhanre të të ndryshme mediatike (shtypi: gazeta ose elektronike: TV por edhe faqe interneti).

¹ Ne e interpretojmë “promovimin e integritit të migrantëve nga mediat” në një mënyrë strikte: p.sh. promovimi i prezantimit të drejtë dhe polifonik të migranteve në media, në angazhimin e migrantëve si gazetarë, etj – p.sh. ne e analizojmë atë në mënyrë që të kontribuojmë në promovimin e një shoqërie integruese dhe ne e shohim këtë si një qëllim të tërthortë etike të sektorit të mediave.

STUDIMI PILOT duke përdorur TREGUESIT MEDIVA

Përzgjedhja e Mediave në çdo vend për Studimin Pilot

Kjo përzgjedhje nuk ka për qëllim vlerësimin e mediave në nivel kombëtar, por synon të ofroj një vlerësim se si mediat e tipeve dhe e orientimeve ideologjike të ndryshme merren me çështjen e migrimit dhe promovojnë (ose jo) integrimin e migrantëve. Përzgjedhja ka si qëllim të mbuloj një spektër të mediave pa pretenduar gjithësi se mund të vlerësojë në përgjithësi të gjitha mediat e një vendi të caktuar. Për më tepër, përzgjedhja jonë synon të sigurojë material të mjaftueshëm për krahasimin e rezultateve midis shteteve për sa i përket pikëve si dhe vlerësimit cilësor.

Mediat për Studimin Pilot (në gjashtë shtete: GR, IRL, IT, NL, PL, Britania e Madhe)

1. **Gazeta kombëtare**
2. **Gazeta kombëtare** (nëse është e përshtatshme, zgjidhni një gazetë të dytë me orientim të ndryshëm ideologjik (e majtë-e djathtë), të natyrave të ndryshme (cilësore vs sensacionale)).
3. **Gazetë e lire** - (nëse është e përshtatshme, ju mund të zgjidhni midis gazetave lokale vs. gazetave të lira që qarkullojnë në nivel kombëtar në qytetë të mëdha si City Press, Metro etj)
4. **Gazeta Lokale** - (nëse është e përshtatshme, shih shënim më lart)
5. **Buletini i lajmeve në TV** – temat kryesore të edicionit qendror të lajmeve (në varësi të vendit: buletini i lajmeve i orës 20:00 ose 21:00 ose dhe i orës 6 pm në qoftë se atë orë transmetohet buletini qendror i lajmeve)
6. **Buletini i lajmeve në TV** - (një kanal i dytë televiziv që është i një orientimi të ndryshëm ideologjik (i majtë vs i djathtë) apo i pronësisë së ndryshme (kanal publik vs kanal privat) ose edhe i karakterit të ndryshme (cilësor vs sensacional)).
7. **Faqe elektronike lajmesh** - (në rastin kur një faqe elektronike nuk është e lidhur me një gazetë dhe ka auditor ose lexueshmëri të lartë)

Në çdo vend në përzgjedhim **jo më pak se 5 institucione mediatike.**

Si të përllogariten pikët për secilin tregues:

Ne plotësojmë përgjigjet tek nën-pyetjet dhe kështu i japim pikë pyetjeve specifike. Në më pas përllogarim pikët totale për secilin tregues.

Ne ofrojmë një shpjegim të shkurtër (5-10 rreshta, ose aq sa në e konsiderojmë të domosdoshme dhe nëse gjykojmë es shpjegime më të detajuara janë të nevojshme) poshtë treguesit në lidhje me rezultatin (p.sh. nëse ata thonë se nuk kanë trajnim mbi diversitetin, por ata shpjegojnë se kanë përdorur një të tillë dhe ajo u hoq vitin e kaluar për shkak se mungesës së fondeve apo se ata janë duke planifikuar ngritjen e një skemë të re trajnimit mbi diversitetit – të gjitha këto janë vlerësime cilësore të përgjigjeve të kodifikuara, që në duam ti regjistrojme për një vlerësim më të mirë të pikëve tona)

Ne, gjithashtu, citojmë pjesë nga intervistat përkatëse me drejtorët e lajmeve, në gjuhën në të cilën intervista u zhvillua. Në ruajmë arshivën e kodifikimit të përmbajtjes së mediave.

Pikët totale për secilin tregues janë mesatarja e pikëve të nën-treguesve.

Pikët mesatare dhe shpërndarja e rezultateve të nën-treguesve: Në rast se ekzistojnë dallime të mëdha në pikat e marra nga disa nën-tregues që e sjellin rezultatin e përgjithshëm afër nivelit neutral ose mesatare (3) (ndërkohë që mund të ketë brenda të njëjtit tregues pikë shumë të ulta (1) si dhe shumë të larta (5)), në duhet të bëjmë një kontroll të dyfishtë mbi vlerësimin tonë dhe të shpjegojmë këto kontradikta në një shënim përfundimtar mbi rezultatin e përgjithshëm të treguesit specifik.

Formati për prezantimin e rezultateve:

Rezultatet paraqiten për çdo media të studiuar në mënyrë të veçantë.

Rezultatet prezantohen në FLETËN E VLERËSIMIT TË MEDIAVE për çdo institucion mediatik (gazetë, kanal televiziv, faqe elektronike), ku në i japim pikë çdo treguesi dhe pastaj shpjegojmë shkurtimisht pse e dhamë këtë rezultat (në lidhje me nën-pyetjet që janë pjesë përbërëse e çdo treguesi dhe/ose shënimet/vëzhgimet që në kemi shkruar poshtë çdo treguesi kur plotësuam pyetësorët)

Ne së pari prezantojmë rezultatin e treguesit 2, pastaj 3 dhe pastaj 4. Rezultati i Treguesit 1 do të paraqitet i fundit në mënyrë që të kontekstualizojmë se ajo që kemi bërë është një vlerësim indikator i përmbajtjes/përfaqësimit të migrantëve në këtë institucion mediatik i cili paraqitet më funksional për studimin tonë pilot sesa për një studim të plotë afatgjatë.

Me fjalë të tjera ne do të vejmë theksin në atë që është bërë dhe atë që duhet të bëhet për të nxitur prodhimin/bërjen e lajmeve, punësimin/rekrutimin dhe praktikën e trajnimit që janë të favorshme për të reflektuar diversitetin dhe promovimin e integritit të migrantëve, **sesa një studim më vete** mbi mënyrën se si një institucion mediatik paraqet migrantët dhe temat që lidhen me to.

Kontekstualizimi i vlerësimit: Çdo fletë profili është e shoqëruar nga:

- një adresë elektronike e raportit MIPEX për vendin përkatës (pra një ekspozitë e përgjithshme e situatës së integritit të migrantëve në atë vend) ku institucioni mediatik është i lokalizuar.
- Një dokument më i gjatë prej disa faqesh që në kemi përgatitur mbi bazën e një pyetësori më të detajuar në të cilin ne japim më shumë informacion në lidhje me metodën pikëdhënies.

Shënim! Në seksionin e bërjes së lajmeve/praktikave të prodhimit, dispozitës së personelit të specializuar si dhe programimin në marrim parasysh madhësinë e institucionit mediatik (diferenca, për shembull, midis mediave publike me 100 gazetarë dhe një faqeje elektronike me tre redaktorë) në vlerësimin e praktikave ekzistuese përse i përket programeve të specializuara dhe gazetarëve.

Pikët/Rezultatet për të gjithë Treguesit

Shumë i lartë/shumë pozitiv = 5

I lartë/pozitiv = 4

I mesëm/neutral = 3

I ulët/negativ = 2

Shumë i ulët/shumë negativ = 1

STUDIMI PILOT MBI PËRMBAJTEN E LAJMEVE/MEDIAVE

Metodologjia e përzgjedhjes së Kampionit për Studimin Pilot në lidhje me përfaqësimin e migrantëve në lajme (Treguesi 1, shih më poshtë).

Periudha e marrjes së kampionit: 3 muaj, javën e fundit të çdo muaji, 7-ditë interval, duke filluar nga e Mërkura dhe duke mbaruar të Martën

Datat e përzgjedhura:

- 23-29 Nëntor 2011
[ne e anashkaluam Dhjetorin për arsye të festave të Krishtlindjes të cilat ndikojnë në frymën e mbulimit të lajmeve gjatë kësaj periudhe]
- 25-31 Janar 2012
- 7-28 Shkurt 2012
[ne përzgjedhëm tre javë me qëllim që të zmadhojmë kampionin tonë dhe ta bëjmë atë më aktual]

Njësia e analizës:

Vlerësimi i përmbajtjes së lajmeve/mediave përdori si njësi analize

- artikuj/raporte/lajme individuale në të GJITHË gazetat
- lajmet kryesore të buletinin qëndror të lajmeve të mbrëmjes në televizion (ne analizojmë të GJITHË buletinin e lajmeve të mbrëmjes)

Teksti i plotë ose skeda e plotë audiovizuale për TV është analizuar në secilin rast (jo vetëm titujt për shembull).

Ne përlogarisim numrin total të lajmeve/artikujve në gazetë për periudhën e koduar dhe se sa nga këto lajme/artikuj kanë të bëjnë me migracionin ose i referohen migrantëve (p.sh. në totalin prej 790 lajmeve/artikujve në javën e Nëntorit, 35 nga ato janë lajme/artikuj mbi migracionin ose migrantët).

TREGUESI 1 - PËRMBAJTJA E LAJMEVE/MEDIAVE

1.1 Përfaqësimi pozitivë (5) vs. negativë (1) i shtetasve të vendeve të treta në lajme

Vlerësimi sasior (përqindja e lajmeve pozitive/negative në numrin total të lajmeve dhe atyre specifike për migrantët). Faqja e parë, numri i lajmeve, në gazeta apo faqe elektronike lajmesh/lajmet kryesore të buletinit të mbrëmjes në TV/lajmet kryesore të buletinit të mëngjesit në radio përgjatë javës së parë të çdo muaji për 3 muaj.

I lartë = më pozitive se vendasit

I mesme = e barabartë me vendasit

I ulët = më shumë negative se vendasit

Udhëzime për vlerësimin pozitive vs negativ:

Çfarë duhet të konsiderohet si negative?

- Atribuimi i karakteristikave negative migrantëve, nëpërmjet etiketimit, përdorimit të mbiemrave kualifikues, duke përfshirë stereotipe negative që i përcaktojnë migrantët si të ndryshëm dhe/ose inferior.
- Lidhja e migrantëve me tema specifike negative, p.sh. probleme sociale, ilegaliteti, kërcënime.
- Shpjegimet e dhëna për pozitën specifike apo akteve të kryera nga migrantët të cilat përqëndrohen më shumë në fajësimin e tyre sesa në kërkimin e identifikimit të kontekstit përkatës apo të shkaqeve që fshihen pas tyre.
- Kuadri/korniza e vendosjes së konfliktit dhe antitezat (shih literaturën)
- Diskutime specifike negative, p.sh. fokusimi mbi nënshtrimin e grave myslimane,

Çfarë duhet të konsiderohet si pozitive?

- Atribuimi i karakteristikave pozitive të cilat përqëndrohen në barazinë apo diferencimin pozitiv
- Lidhja me tema pozitive, p.sh. dialogë, kontributi në shoqëri, debati publik
- Shpjegime që përqëndrohen në shkaqet strukturore dhe rrethanat specifike dhe jo thjesht në karakteristikat e vetë migrantëve.
- Kuadri i harmonisë, emancipimit, solidaritetit
- Diskutime specifike pozitive: p.sh. kundër diskriminimit dhe racizmit, imazhe pozitive/qasjet ndaj Islamit, diferenca.

Filtra për balancimin e vlerësimit:

- Numërimi i attributeve negative dhe pozitive që i janë dhënë faktorëve/përfaqësimit të tyre brenda çdo lajmi dhe gjykimi nëse përfaqësimi i përgjithshëm i migrantëve është më negativ, më pozitiv apo më neutral në ton. Nëse titulli apo shembulli është negativ/positiv kesaj i duhet dhënë më shumë peshë (edhe pse ndoshta nuk është përfaqësuese e një artikulli të tërë).
- Treguesi 1.1 është i përbërë nga pikët mesatare të të gjithë artikujve/lajmeve përkatëse të koduara.

1.2 Përfaqësimi aktivë (5) vs pasivë (1) i shtetasve të vendeve të treta në lajme

Vlerësim sasior (përqindja aktive/pasive e prezantimit të migrantëve në lajme)

Migrantë aktivë që kryejnë veprime të mira (shumë pozitive)

Migrantë pasivë që janë objekt i veprimeve të mira ose të këqija të kryera nga të tjerët

(Mesatare)

Migrantë aktivë që kryejnë veprime negative (shumë negative)

1.3 Prezantimi i opinionit dhe i shqetësimeve të migrantëve në lajmet me tematikë të përgjithshme

(përqindja në total e lajmeve/artikujve ku migrantët janë përfaqësuar)

I lartë: mbi % e migrantëve në popullsinë e përgjithshme

Mesatare: përafërsisht e barabartë me % e migrantëve në popullsinë e përgjithshme

I ulët: nën % e migrantëve në popullsinë e përgjithshme

1.4 Opinioni dhe shqetësimet e migrantëve të prezantuara në lajmet specifike mbi temën e migracionit/migrantëve

(përqindja në lajmet specifike mbi migracionin ku migrantët janë përfaqësuar)

I lartë: 51% -100%

Mesatare: 31% -50%

I ulët 0% -30%

Udhëzime se si të llogariten pikët e këtyre treguesve dhe plotësimi i informacionit përkatës në pyetësor:

Treguesit 2-4 duhet të plotësohen nga çdo hulumtues individualisht në bazë të modelit të qarkulluar të pyetësorit (me udhëzimet përkatëse se çfarë duhet regjistruar), sipas metodës ballë-për-ballë ose nëpërmjet një intervistë telefonike me personat përgjegjës të mediave të përzgjedhura për këtë studim. Treguesit 2-4 nuk duhet të plotësohen duke i dërguar pyetësorin me postë elektronike (e-mail) gazetarëve apo drejtuesve të institucioneve mediatike.

Disa tregues janë anashkaluar në vende ku përqindja e popullsisë migratore është më e ulët se 4% e popullsisë në total . Këto janë shënuar në ngjyrë të kuqe.

Në vlerësimin e institucioneve mediatike, hulumtuesi duhet të përcaktojë shkallën e vlerësimit me një nga tre pikat e dhëna, dhe në vazhdim duhet të shkruaj në 5-20 rreshta (në varësi të gamës së informacionit përkatës) pse ai/ajo ju dha treguesve këtë apo atë pikë/vlerësim. Me fjalë të tjera, për qëllime vlerësimi të rezultateve duhet të ketë regjistrim të informacionit përkatës mbi praktikën e adoptuar ose që kanë ekzistuar më parë apo që nuk kanë ekzistuar kurrë në lidhje me çdo nën-tregues. Çdo koment tjetër i bërë nga gazetarët/ drejtuesit mediatik apo personel tjetër i cili ofron informacion duhet gjithashtu të regjistrohet. Nëse është e nevojshme, hulumtuesit mund t'i referohen dokumentave përkatës, faqeve të internetit, apo materialeve të tjera mbështetëse jashtë pyetësorit. Gjithsesi, në çdo rast, ata duhet të shpjegojnë shkurtimisht lidhjen e tyre me pyetësorin.

Rezultatet/Pikët

E lartë = 5

Mesatare = 3

E ulët = 1

TREGUESI 2 – Bërja e Lajme/prodhimi i programeve në Media

2.1 Ekzistenca e seksioneve të specializuara/programeve për lajme nga vendet e origjinës së migrantëve (një herë në javë) - të përdoret vetëm për të vlerësuar mediat në vendet ku totali i migrantët është gjithsej >4% e popullsisë

E lartë: po çdo javë

Mesatare: herë pas here

E ulët: kurrë

SQARIM i rezultatit:

2.2 Nëse ka programe të tilla në radio ose tv ose seksionë të tilla në gazeta, janë ato të transmetuara në zonën e tileshikimit të lartë, apo janë në një nga faqet më të qarkulluara të gazetës/faqe interneti - të përdoret vetëm për të vlerësuar mediat në vendet ku totali i migrantët është >4% e popullsisë

E lartë: zonë e tileshikimit të lartë

Mesatare: jo në zonën e tileshikimit të lartë

E ulët: natën, në kohë të papërshtatshme

SQARIM i rezultatit:

2.3 Ekzistenca e programeve (radio/tv/lajmet/faqe interneti) në gjuhët e grupeve kryesore të migrantëve të vendit (një herë në javë)

E lartë: po

Mesatare: herë pas here, por më pak se një herë në javë

E ulët: kurrë

SQARIM i rezultatit:

2.4 Ekzistenca e gazetarëve të specializuara mbi migrantët dhe çështjet e diversitetit

E lartë: po

Mesatare: përdoret stafi i pavarur

E ulët: jo

SQARIM i rezultatit:

2.5 Filtrimi i lajmeve të lidhura me migrantët

2.5.1 Burimet e lajmeve dhe verifikimi i informacionit (kontrolli i fakteve)

E lartë: duke pyetur njëkohësisht maxhorancën dhe burimet e migrantëve

Mesatare: duke pyetur disa burime (që jo domosdoshmërisht përfshijnë migrantët)

E ulët: agjencia kombëtare e lajmeve

SQARIM i rezultatit:

2.5.2 Kush zgjedh se cilat lajme mbi migracionin duhet të publikohen

E lartë: autori vetë

Mesatare:

E ulët: kryeredaktori/shefi i njësisë

SQARIM i rezultatit:

2.5.3 A ka gazeta ose faqja elektronike e lajmeve seksion të hapur komentesh (si reagim ndaj artikujve të botuar). Nëse ka, e redaktojnë atë për gjuhë raciste?

E Lartë: Po

Mesatare: kur dikush vendos sinjal paralajmërues

E ulët: jo në emër të lirisë së shprehjes

SQARIM i rezultatit:

2.5.4 Adoptimi i udhëzimeve etike së raportimit në lidhje me grupet vulnerabël dhe në veçanti me emigrantët dhe minoritetet

E lartë: pozitive

Mesatare: udhëzime informale mbi raportimin, por pa angazhim të prerë të kompanive

E ulët: Jo

SQARIM i rezultatit:

TREGUESI 3: REKRUTIMI NË MEDIA DHE PRAKTIKAT E PUNËSIMIT

3.1 Zbatimi i masave që kanë për qëllim të sigurojë se stafi i kompanisë pasqyron përbërjen etnike të popullsisë së migrantëve

E lartë: po, të paktën një masë e tillë është zbatuar

Mesatare: një farë ndërgjegjesimi, por nuk ka pasur një implementim konsistent

E ulët: asnjë ndërgjegjesim dhe as implementim

SQARIM i rezultatit:

3.2 Diskriminimi në rekrutimin e shtetasve të vendeve të treta si profesionistë të mediave

3.2.1 Ekzistenca e masave të anti-diskriminuese që synojnë parandalimin e diskriminimit gjatë procesit të rekrutimit të mediave të veçanta

E lartë: po, të paktën një masë e tillë është zbatuar

Mesatare: një farë ndërgjegjesimi, por jo në përputhje me zbatimin e rregullave anti-diskriminuese

E ulët: as ndërgjegjesim dhe as implementim

SQARIM i rezultatit:

3.3 Ekzistenca e skemave në terren që përfshijnë këshillimin ose mbështetjen e individëve migrantë - të përdoret vetëm për të vlerësuar mediat në vendet ku totali i migrantët është >4% e popullsisë

E lartë: po sistematikisht

Mesatare: po me raste

E ulët: jo, asnjëhere

SQARIM i rezultatit:

3.3.1 Monitorimi/vlerësimi i zbatimit të skemave të tilla nga vetë kompania

E lartë: Po, duke kontrolluar nëse skema të tilla kanë rezultuar në rekrutim dhe prodhimin e të dhënave

Mesatare: një përpjekje për të monitoruar apo të vlerësuar/monitorimin, por vetëm me raste/nuk ka të dhëna

E ulët: as monitorimi të vazhdueshëm e as të dhëna

SQARIM i rezultatit:

3.4 Ekzistenca e departamenteve të veçanta të diversitetit në media - të përdoret vetëm për të vlerësuar mediat në vendet ku totali i migrantët është >4% e popullsisë

E lartë: po

Mesatare: jo një departament por një oficer diversiteti

E ulët: jo, asgjë.

SQARIM i rezultatit:

TREGUESI 4 – PRAKTIKAT E TRAJNIMIT NË MEDIA

4.1 Ekzistenca e mundësive të trajnimit të përshtatura për nevojat e migrantëve profesionist të mediave

E lartë: po sistematikisht

Mesatare: po, vetëm me raste

E ulët: jo, asnjëhere

SQARIM i rezultatit:

4.2. a) Ekzistenca e kurseve që synojnë ndërgjegjësimin e profesionistëve të mediave mbi diversitetin dhe si duhet ai të raportohet

E lartë: Po, në përgjithësi

Mesatare: i inkurajuar por jo i detyruar

E ulët: jo

SQARIM i rezultatit:

4.2. b) Ekzistenca e ndonjë detyrimi për të ndjekur kurse të tilla

E lartë: Po, në përgjithësi

Mesatare: e inkurajuar, por jo e detyruar

E ulët: jo

SQARIM i rezultatit:

4.3. Përfshirja e emigrantëve ose e përfaqësuesve të minoriteteve/e ekspertëve në hartimin dhe/ose implementimin e të tilla kurseve trajnimi mbi diversitetin

E lartë: Po, sistematikisht

Mesatare: ndonjëherë

E ulët: jo, asnjëhere

SQARIM i rezultatit:

4.4. Monitorimi dhe sistemet e raportimit për trajnimin mbi diversitetin etno-kulturor

E lartë: Po, sistematikisht

Mesatare: herë pas here

E ulët: jo, asnjëhere

SQARIM i rezultatit:

4.5. Qëllimet e Diversiteti të përfshira në politikat e trajnimit të burimeve njerëzore për të gjitha nivelet e stafit

E lartë: po, ekzistojnë, duke synuar për të gjitha nivelet e stafit

Mesatare: Qëllimet e diversitetin janë ekzistuese, por vetëm për grupe të caktuara të personelit/por jo në mënyrë specifike të lidhura me trajnimin

E ulët: nuk ekziston

SQARIM i rezultatit:

